



Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian

E - buletini no.17

Janar 2019

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Aksioni për Zhvillim Rural (AZR) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merret parasysh për të pasqyruar mendimet e Bashkimit Evropian



Parlamenti Kombëtar Rural si Zëri i Banorëve Rural

'Kosta Veselinov' 3a,
1000 Skopje
R. Macedonia
T: +389 (2) 3075 506
F: +389 (2) 3075 503
email: info@ruralnet.mk
zg.akrra@yahoo.com

Organizatrat e implementimit





Zhvillimi i potencialit për hulumtim dhe përfaqësim tek organizatat qytetare

Në periudhën prej shkurt deri dhjetor 2018, përfaqësues prej 52 organizatave qytetare, nga 8 rajonet e planifikimit të Republikës së Maqedonisë, kanë marrë pjesë në më tepër punëtori lidhur me ngritjen e kapaciteteve të organizatave, krijimit të politikave për zhvillim rural, përfaqësim dhe lobim. Këto punëtori ishin organizuar në kuadër të projektit “Parlamenti Rural Kombëtar si Zëri i Popullatës Rurale» i zbatuar nga CNVP, Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë (RZR i RM) dhe Aksioni për Zhvillim Rural (AkRRA). Pas përfundimit të ciklit të punëtorive, prej secilit rajon të planifikimit ishin zgjedhur disa organizata, që ishin të përfshirë në procesin e përpunimit të dokumenteve të shkurta për politika për zhvillim rural.

Në periudhën e njëjtë ishte zbatuar edhe një hulumtim në 8 rajonet e planifikimit me anë të së cilës ishin identifikuar problemet dhe sfidat me të cilat përballohet popullata rurale. Gjithsej 840 përfaqësues të sektorit joqeveritar dhe vetëqeverisjes lokale ishin përfshirë në hulumtimin. Të dhënat e fituara ishin të analizuar me qëllim të identifikimit të temave, ato aktuale dhe relevante, për nevojat e popullatës rurale në secilin rajon.

Organizatave qytetare që ishin pjesëmarrës aktiv në ciklin e punëtorive për ngritjen e kapaciteteve, më tutje ishin përfshirë edhe në një proces të trajnimit dhe mbështetjes për mentorim për krijimin e dokumenteve të shkurta për politika të zhvillimit rural, në pajtim me temat e përcaktuar me anë të hulumtimit.

Kapaciteti dhe shkathtësitë e organizatave qytetare rurale për njohje dhe zgjidhje të sfidave në fushën e tyre të veprimit është jashtëzakonisht i dobët. Mungesa e shkathtësive përkatëse për përfaqësim sjell më tepër vështirësi në hapjen e debateve dhe ngritjes së çështjeve me interes dhe rëndësi për komunitetin lokal. Si pasojë, kontributi dhe ndikimi i organizatave qytetare rurale për ndryshime të situatës aktuale dhe politikave për zhvillim rural janë të kufizuar dhe prandaj me rëndësi të madhe është zhvillim i njohurive dhe shkathtësive analitike, prezantuese dhe të menaxhimit.

Qëllimi i procesit të mentorimit të organizatave qytetare ishte që të mësohen të përgatitin dokumente të shkurta politike, në rastin konkret, për tema paraprakisht të identifikuar nga fusha e zhvillimit rural. Në këtë mënyrë





mundësohet organizatave të zhvillojnë informacione të shpejta dhe relevante për zhvillimin lokal të komuniteteve rurale, mundësitë për financim lidhur me zhvillimin rural dhe ndikimin mbi rajonet rurale. Ky proces gjithashtu ju ka ndihmuar organizatave që të informojnë opinionin në lidhje me politikat për zhvillim rural dhe të përmirësojnë bashkëpunimin me mediet dhe palët tjera të interesuara nga rajonet rurale.

Temat, mbi të cilat janë krijuar dokumentet e shkurta për politika, kanë dalë nga analiza e bërë paraprakisht dhe janë specifike për rajonin në të cilin veprohet.

| Rajoni | Tema të identifikuara nga analiza | Titulli i dokumentit të shkurtë për politika | OJQ |
|-----------------------------|---|--|---|
| Rajoni Lindor | Përmirësimi i kushteve sociale-ekonomike me anë të mobilizimit të mjeteve dhe krijimit të mundësive për investime në sektorin afarist privat të rajonit lindor rural. | Zhvillimi i turizmit në rajonin Malesh-Pijanec | -Shoqata-Qendra për Bimë Shëruese dhe Frute Pyjore – Ambrozija -Qendra Edukative për Ruajtjen e Natyrës – f. Negrevë -Organizata e Grave të Komunës së Pehçevës |
| Rajonit Veri-Lindor | Përmirësimi i konkurrencës së prodhimit lokal me anë të mbështetjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për nevojat e popullatës lokale | Përmirësimi i konkurrencës së prodhimit lokal dhe zhvillimit të qëndrueshëm | -Shoqata për Zhvillim Rural Grupi Lokal i Aksionit – Aber 2015 |
| Rajoni i Shkupit | | | |
| Rajoni i Pellagonisë | Sigurimi i mundësive për investime për të rinjtë për prodhimtari organike dhe zhvillim i turizmit rural, me qëllim të përmirësimit të ekonomizimit dhe të krijimit të kushteve sociale-ekonomike në rajonin e Pellagonisë | Prodhimtaria e ushqimit organik si vegël për zhvillim rural dhe krijimi i kushteve të volitshme sociale-ekonomike në rajonin e Pellagonisë | -Shoqata për Mbrojtje, Edukim dhe Promovim të Ushqimit – Sllou Fud Manastir -Shoqata e Bletarëve Nektar |
| Rajoni i Pollogut | Përmirësimi i kushteve për të rinjtë (mbrojtja shëndetësore, çerdhe për fëmijë, manifestime kulturore, ruajtje të traditës) për të krijuar një mjedis më të mirë për ardhmëri të mirë për të rinjtë | Si të krijojmë mjedis më të mirë për të rinjtë | -GLA Skardus -OJQ Ekoprodukt Tetovë -Qendra Kulturore e të Rinjve - Tetovë |
| Rajoni Jugperëndimor | Prezantim i llojllojshmërisë në prodhimtarinë bujqësore me përdorimin e teknikave inovative dhe praktikave dhe mundësi të rritura për financim dhe mobilizim të mjeteve | Prodhime të reja për zhvillim lokal në Rajonin e Ohrit-Strugës | -Rrjeti i Fermerëve të Rinj -Shoqata ORTET – Kuraticë -Rubankult -Shoqata Matica – Strugë |
| Rajonit Jug-Lindor | Përmirësimi i manifestimeve kulturore dhe aktiviteteve, si dhe rritje të mundësive të përgjithshme të investimit me fokus të veçantë të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, me qëllim të rriten mundësitë për punësim të të rinjve në rajonet rurale. | Krijimi i mundësive për punësim të të rinjve në rajonet rurale | -Shoqata Krana Plus -CELOR – Qendra për Zhvillim Rural |
| Rajoni i Vardarit | Përmirësimi i shërbimeve publike (shëndetësore, financiare dhe shërbimet e sigurisë) dhe rritje të aktiviteteve kulturore me qëllim të rritjes së tërheqjes së rajonit rural në rajonin e Vardarit. | Rritje të tërheqjes së rajoneve rurale në Rajonin e Vardarit: Zhvillimi i fushës së certifikuar f. Begnishtë Rruga e rrushit organik | -Shoqata e Qytetarëve EKOVIDA Negotinë -Shoqata e prodhuesve të ushqimit organik BIOVIDA – Kavadar |

Dokumentet e krijuara nga gjitha 7 rajonet e planifikimit, në aktivitetet vijuese, do të jenë lëndë e diskutimit si dhe pjesë e aktiviteteve të projektit.



Në kuadër të Programit për Ri-Grantim të projektit “Parlamenti Kombëtar Rural si Zëri i Popullatës Rurale” ishin aprovuar 10 projekte. Periudha e zbatimit të tyre është prej shtator 2018 deri më janar 2019.

1. Titulli i projektit:

Komunat rurale dhe banorët bashkërisht krijojnë besimin dhe jetën në komunitetin lokal

Zbatues:

- “Koalicioni Rural” Kumanovë
- Shoqata për Zhvillim, Edukim dhe Etikë Ekologjike - POLIMAT 13”

Qëllime të projektit:

Përforcimi i kapacitetit të organizatave qytetare për kyçje aktive në proceset e vendimmarrjes dhe krijimin e politikave në komunat e Bogdanci dhe Krivogashtani.

Nxitja e dialogut mes organizatave qytetare dhe vetëqeverisjeve lokale në komunat e Bogdanci dhe Krivogashtani dhe themelimi i një procesi të bashkëpunimit të vazhdueshëm.

Aktivitete:

Zbatimi i projektit filloi me përcaktimin e shkallës së bashkëpunimit mes vetëqeverisjes lokale, bashkësitë lokale dhe organizatat qytetare në dy komunat, me anë të pyetësorëve. Nga të dhënat e fituara të plotësimit të pyetësorëve dolën temat për trajnim që ishin pjesë e aktiviteteve të projektit:

- Trajnim për udhëheqje me projekte;
- Trajnim për planifikim strategjik;
- Trajnim për monitorim të politikave publike.

Pas përfundimit të trajnimeve ishin zhvilluar seanca forumi dhe takime me palët e interesuara. Si aktivitet përfundimtar i projektit ishte krijimi i Strategjive për Bashkëpunim të komunave Bogdanci dhe Krivogashtani me sektorin qytetar.

www.rural.mk

<https://www.facebook.com/RuralCoaliton/>





2. Titulli i projektit:

Mësimi gjatë gjithë jetës për zhvillim rural



Zbatues:

- Shoqata për avancimin dhe zhvillimin e arsimit për të rritur "Rrjeti për Mësimin Gjatë Gjithë Jetës" Tetovë
- Shoqata për Zhvillim Rural Grupi Lokal i Aksionit GLA Skardus, Jegunovcë.

Qëllime të projektit:

- Përforcimi i kapaciteteve të palëve të interesuar për përmirësimin e gjendjes në mjediset rurale, me anë të përfshirjes së tyre në procesin e krijimit të politikave që përgjigjen nevojave të tyre.
- Rritje të njohurive dhe shkathësive për përdorimin e masave dhe programeve për zhvillim rural.
- Me anë të rrjetëzimit të aktorëve të ndryshme komunitet do të shkëmbehen përvoja dhe praktika të mira nga fusha dhe në këtë mënyrë do të sigurohet njohuria e nevojshme për nxitjen e zhvillimit rural.

Aktivitete:

Projekti filloi me identifikimin e organizatave që punojnë në fushën e zhvillimit rural në Rajonin e Pollogut. Në kuadër të këtij projekti ishin zhvilluar trajnime për përfaqësim dhe lobim, shoqërim dhe partneritete, mundësi për përdorimin e IPARD/LEADER programet dhe trajnimet për mësimin e gjatë gjithë jetës në kontekst të zhvillimit rural. Në konferencën përfundimtare ishin prezantuar mundësitë për rrjetëzim të organizatave qytetare të Rajonit të Pollogut.

www.lagskardus.mk

www.facebook.com/lagskardus





3. Titulli i projektit:

Me anë të veprimit dhe përfaqësimit të përbashkët deri në biznes të suksesshëm për fermerët në Likovë dhe Staro Nagoriçane

Zbatues:

- Shoqata shumë etnike dhe joqeveritare femërore – “Linda” Kumanovë
- Fondacioni për Zhvillim të Ndërmarrjeve ë Vogla dhe të Mesme Kumanovë

Qëllime të projektit:

Rritja e nivelit të veprimit të përbashkët të organizatave lokale qytetare në përfaqësimin dhe trajtimin e problemeve me të cilat përballohen fermerët dhe popullata lokale në komunat rurale të Likovës dhe Staro Nagoriçane.

Aktivitete:

Qëllimi i projektit ishte arritur me anë të realizimit të trajnimeve për menaxhim organizativ dhe punë të shoqatave, përgatitja e projekteve të BE-së, trajnim për përfaqësim dhe rrjetëzim, organizimi i seancave informative, trajnime për inovacione në bujqësi dhe biznes, zgjedhja e ideve afariste dhe hartimi i planeve afariste.



4. Titulli i projektit:

e-Portal Turistik për rajonet rurale të Rajonit Verilindor

Zbatues:

- Shoqata për Mbrojtjen e Mjedisit jetësor, Atraksionet Kulturore-Historike dhe Shëndetit të Njeriut “IZVOR”, Kratovë
- Shoqata EKOKRATER KRATOVE – Kratovë

Qëllime të projektit:

Themelimi i një mekanizmi të qëndrueshëm për ndërtimin e partneriteteve mes OJQ-ve, sektorit afarist dhe popullatës lokale me anë promovimit të trashëgimisë kombëtare dhe kulturore në rajonet rurale të rajonit verilindor në fushën e turizmit rural me qëllim të përforsimit të ndikimit të OJQ-ve në procesin e rritjes sociale dhe ekonomike të viseve rurale.

Aktivitete:

Realizimi i punëtorive për standarde turistike në rajonet rurale dhe krijimi i e-portalit turistik janë pjesë e aktiviteteve të projektit “E-Portal Turistike i Viseve Rurale të Rajonit Verilindor”. Ky projekt do të kontribuojë për përmirësimin e bashkëpunimit mes organizatave qytetare me pushtetin lokal, sektorin afarist dhe popullatën lokale me qëllim të përfshirjes së tyre të madhe në proceset e zhvillimit rural në komunat e Kratovës, Staro Nagoriçane, Rankovce dhe Kriva Pallankë.

<http://www.northeastregion.gov.mk>





5. Titulli i projektit:

Përforcimi i kapaciteteve të organizatave qytetare për arritjen e nivelit më të lartë të qëndrueshmërisë dhe fuqisë së përfaqësimit



Zbatues:

- Shoqata e Prodhuesve të Llojeve Kopshtare dhe Luleve "HORTI EKO", Strumicë
- Shoqata për Qëllime Arsimore-Edukative "DM LANGUAGES"

Qëllime të projektit:

Të rritet kapaciteti i anëtarëve të "Horti Eko", dhe "DM Languages" që do të rezultojë me njohjen e tyre si aktorë kryesor në përfaqësimin e interesave të popullatës rurale në nivel lokal, rajonal madje edhe në atë kombëtar.

Aktivitete:

Si pjesë e projektit ishin realizuar disa aktivitete:

- Trajnim për planifikim të anëtarëve të të dy organizatave partnere;
- Trajnim për njohuri financiare në bujqësi.

Pas përfundimit të trajnimit u realizuan 3 sesione informative për format e bashkimit në bujqësi ku morën pjesë prodhues bujqësor dhe qytetarë nga rajoni i Strumicës.

Si ngjarje përfundimtare u organizua tryeza përfundimtare me përfshirjen e të gjitha palëve të prekura në bujqësi për shqyrtim të mekanizmave efektiv për aferim dhe përmirësim të bashkëpunimit mes organizatave qytetare dhe pushteteve lokale.

<https://www.facebook.com/horti.eko.3>





6. Titulli i projektit:

SHËRBIMI+ Përforcimi financiar i organizatave lokale rurale nëpërmjet zmadhimit të kapaciteteve të tyre për realizimin e shërbimeve të paguara ndaj anëtarësisë

Zbatues:

- Qendra për Qëndrueshmëri dhe Edukim të Avancuar, Manastir
- Shoqata për Zhvillim të Qëndrueshëm PELISTER f. Rotino

Qëllime të projektit:

Përmirësimi i kapaciteteve të organizatave rurale lokale në fushën e punës financiare dhe organizative, përforcimi i kapaciteteve të organizatave rurale lokale për furnizimin e shërbimeve cilësore për anëtarësinë, rritjen e organizatave lokale rurale të Rajonit të Pellagonisë dhe përforcimi i bashkëpunimit të ndërsjellë me anë të shkëmbimit të praktikave më të mira në fushën e furnizimit të shërbimeve cilësore për anëtarët.

Aktivitete:

Përforcim financiar i organizatave lokale rurale u arrit nëpërmjet zbatimit të aktiviteteve nga projekti Shërbim+. Në suaza të këtij projekti u realizuan më shumë trajnime:

- Trajnimi për punë financiare organizative;
- Trajnim për krijim të udhëzuesit për punë financiare të organizatave;
- Trajnim për krijim të pakos së shërbimeve për anëtarët e organizatave qytetare;
- Punëtori për demonstrim dhe shpërndarje të praktikave më të mira.

7. Titulli i projektit:

FERMA ORGANIKE – Kohezioni rural për rritje të potencialit të turizmit rural dhe zhvillimit të qëndrueshëm rural ekonomik

Zbatues:

- Shoqata "Qendra kreative RUBANKULT", Strugë
- Shoqata e Bletarëve "MATICA 2012", Strugë

Qëllime të projektit:

Projekti ka për qëllim të mbështet zhvillimin e mjedisve rurale në rajonin e Strugës me anë të përforcimit të kapaciteteve të aktorëve në bujqësi, bletari dhe turizmit rural, për veprim të përbashkët të integruar në fushën afariste, si dhe lidhjen e tyre për veprim të përbashkët para institucioneve publike, lokale dhe qeveritare, me qëllim që nevojat e tyre, kërkesat dhe mendimet të bëhen pjesë e vendimeve dhe politikave që i krijojnë institucione e kësaj fushe.



Aktivitete:

Aktivitetet e zbatuara të projektit në periudhën e kaluar janë: formimi i lëvizjes për zhvillim rural, punëtori edukative për prodhimtari organike, Panairi për mjaltë dhe Panairi për ushqim organik dhe tradicional.

www.matica.com





8. Titulli i projektit:

“Përforcimi ekonomik i grave rurale të përkatësive të ndryshme etnike të Rajonit Lindor dhe Perëndimor”



Zbatues:

- Shoqata e grave fermer “AGRO-VINKA”, Vinica
- Shoqata “Radika-De”, Dibër

Qëllime të projektit:

Nëpërmjet themelimit të bashkëpunimit më të mirë dhe shkëmbimit të përvojave, edukimit, promovimit, bashkëpunimit dhe përpjekjes së përbashkët që të nxiten të rinjtë dhe gratë nga bashkësitë e ndryshme etnike nga rajoni Lindor dhe Perëndimor (komunat: Vinicë, Dibër, Mavrovë – Rostushë dhe Centar – Zhupa) që të njihen me bazat e sipërmarrjes dhe artizanaleve, të ndajnë përvojat në dy rajonet, të zhvillojnë idetë e tyre afariste dhe në këtë mënyrë të rrisin mundësitë e tyre për pavarësi ekonomike. Njëkohësisht, nëpërmjet shfrytëzimit të përvojave dhe praktikave të mira, do të motivohen për nisje të bizneseve familjare, me çfarë do të zvogëlohet papunësia dhe trendi i largimit të të rinjve nga vendi në këto mjedise rurale.

Aktivitetet:

Në suaza të këtij projekti u realizuan më shumë trajnime:

- Trajnime për sipërmarrje;
- Planifikim afarist;
- Trajnime kreative praktike për teknikat e thurjes dhe qëndisjes.

Projekti u rumbullakosua me ngjarjen multietnike ku gratë nga dy rajonet kishin mundësi që të promovojnë prodhimet dhe idetë e tyre.

www.darijarakotvorbi.mk

www.radikade.mk





9. Titulli i projektit:

Krijimi i listës fillestare të produkteve tradicionale për mjedise të qëndrueshme rurale - SILOS

Zbatues:

- Shoqata për Mbrojtje, Promovim dhe Edukim për Ushqim "Slow Food Bitola" - Manastir
- Shoqata për Mbrojtjen dhe Promovimin e Piperit të Bukovit "Presidum Bukovo" - Manastir

Qëllime të projektit:

Të sigurohet një bazë nisjeje për dukshmëri më të madhe të produkteve lokale tradicionale, me anë të prezantimit të LTP me mundësi për mbindërtim të mëtutjeshëm, dhe nga aty edhe në rolin e platformës së bashkëveprimit të ndërsjellë dhe kyçje të përfaqësuesve tjerë të rajoneve tjera.

Të iniciohet rritje të vetëdijes tek organizatat qytetare të dy rajoneve për rëndësinë e aktiviteteve të përbashkëta dhe komunikimin me organizatat lokale tjera, institucionet dhe/ose biznese, me anë të zbatimit të fushatës së përbashkët dhe shprehjes së qëndrimeve të përbashkëta me anë të dokumenteve të shkruara.

Aktivitete:

Në kuadër të aktiviteteve të projektit ishte krijuar lista me produkte tradicionale. Njëherë lista mundëson dukshmëri më të madhe të këtyre produkteve dhe promovimi i tyre me anë të fushatës që zbatohen gjatë zbatimit të projektit.

www.slowfood.mk

<https://www.facebook.com/slowfood.bitola?fref=ts>

<https://twitter.com/slowfoodmacedon>

<https://twitter.com/slowfoodbitola>

<https://mk.linkedin.com/in/slowfoodmacedonia>

10. Titulli i projektit:

Të drejtë ndaj natyrës

Zbatues:

- Shoqata e Qytetarëve «EKOVIDA»
- Shoqata e prodhuesve të ushqimit organik "Biovida" – Kavadar

Qëllime të projektit:

- Rrjetëzimi i aktorëve të sektorit bujqësor në rajonet rurale (fermerë, përpunues, turistë, hotelier, blerës, trupa certifikues, trajnerë, etj.)
- Zhvillimi i konceptit që do të sigurojë kthim të mënyrës tradicionale të kultivimit të kulturave bujqësore, me lloje dhe specie që janë autoktonë dhe të adaptuar kushteve mikro-klimatike që paraqiten në fushat rurale të Rajonit të Tikveshit.
- Trajnim për prodhimtari të produkteve organike.
- Vendosje të siguruar të kulturave bujqësore në kapacitetet e përpunimit.



Aktivitete:

Në kuadër të projektit "Të Drejtë ndaj Natyrës" ishin zhvilluar më tepër trajnime për promovim të teknikave të prodhimit të organike. Ishin bërë disa vizita në terren të fermave organike që ishin ndarë si shembuj të mirë të prodhuesve të certifikuar organik. Si rezultat përfundimtar, ishte hartuar një manual për prodhimtari organik, që ishte promovuar në kuadër të këtij projekti.





Të drejtë ndaj natyrës

Në kuadër të programit për ri-grantim të projektit "Parlamenti Rural Kombëtar si Zëri i Popullatës Rurale", shoqata e qytetarëve "Ekovita" dhe shoqata e prodhuesve të ushqimit organik "Biovita" e zbatojnë projektin "Të Drejtë ndaj Natyrës" të nxitur nga kushtet e volitshme për zhvillim të prodhimtarisë organike që ekzistojnë në Rajonin e Tikveshit. Shoqatat kanë filluar me aktivitete gjatë muajit gusht, kur kanë hartuar 18 prodhuesve aktuale organik të rajonit dhe kanë evidentuar 19 prodhues potencial, duke siguruar informacionet e nevojshme për përzgjedhje të 10 fermerëve në të cilat ishte zbatuar prodhimtaria organike dhe janë përgatitur të kalojnë nëpër procesin e kontrollit dhe certifikimit. Ishin përfshirë fermerë me prodhimtari bimore, blgtorale dhe bletare të fshatrave: Koreshnicë, Çelevec, Timjanik, Marena, Begnishte.



Projekti ka realizuar më tepër punëtori dhe trajnime, duke filluar nga muaji tetor, kur ishin organizuar punëtori në f. Begnishte, në temën "Bazat e Prodhimtarisë Organike" dhe në Negotinë në Agjencinë për Punësim në temën "Bazat e Prodhimtarisë Organike dhe Kushtet për Vetëpunësim në Veprimtarinë Bujqësore". Në nëntor, në f. Marena ishte realizuar punëtori në temë "Parimet Themelore të Prodhimtarisë Organike" - në kopsht vere të vogël private, me theks në rregullore dhe kërkesa specifike të standardit për prodhimtari organike të rrushit për verë dhe prodhimtari organike të verës dhe pije joalkoolike nga rrushi.

Në dhjetor, projekti ka zbatuar një trajnim në temën «Teknika të Kultivimit të Kulturave Specifike Bujqësore sipas Parimeve të Prodhimtarisë Organike», e synuar për 10 fermerët kanë zbatuar mënyrën organike të prodhimtarisë dhe në të cilët është përgatitur dokumentimi i nevojshme për zbatimin e kontrollit profesional dhe certifikimit.

Si rezultat i zbatimit të suksesshëm të aktiviteteve të projektit, 10 fermerë të Rajonit të Tikveshit kanë fituar certifikate për prodhimtari organike. Janë certifikuar 4,33 ha hardhi rrushi, 1,09 bimë shëruese dhe aromatike, 71 kokë gjedhe, 36 familje bletësh dhe një verëri e vogël familjare që prodhon verë dhe lëng nga rrushi.





Komunat rurale dhe banorët bashkërisht krijojnë besimin dhe jetën në komunitetin lokal



“Koalicioni Rural” me ngjarjen përfundimtare më 26.12.2018 i ka përmbyllur aktivitetet e projektit “Komunat rurale dhe banorët bashkërisht krijojnë besimin dhe jetën në komunitetin lokal”, të cilin ka realizuar bashkëpunimi mes partnerëve të shoqatës «Polimat 13» nga Bogdanci, në kuadër të programit për ri-grantim të projektit «Parlamenti Rural Kombëtar si Zëri i Popullatës Rurale». Në ngjarjen përfundimtare ishin prezantuar pikat kryesore nga strategjitë për bashkëpunim mes organizatave qytetare dhe komuniteteve lokale që ishin hartuar për komunat Krivogashtani dhe Bogdanci. Këto janë komunat e para rurale në Maqedoni që kanë këto strategji.





Zhvillimi strategjik i turizmit rural

Shoqata e qytetarëve "Koalicioni Rural", muajin korrik e ka shënuar me një ngjarje të projektit "Zhvillimi Strategjik i turizmit Rural - baza për lidhje plotësuese dhe plotësim të politikës industriale dhe zhvillimit të qëndrueshëm i RM-së", i mbështetur financiarisht nga Fondacionit YES Network+, shërbimi sipërmarrës për të rinj. Në kuadër të ngjarjes ishte prezantuar ueb platforma e parë në të cilin do të mund të gjenden mbi 120 kapacitete, që ofrojnë shërbime turistike në rajonet rurale në R. e Maqedonisë. Gjithashtu, ishte hartuar edhe raporti i monitorimit për efektet e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Turizëm Rural 2012-2017 me rekomandime se çfarë duhet të merret parasysh gjatë përgatitjes së strategjisë vijuese për turizëm rural. Platforma ishte marrë edhe nga ana e Agjencisë për Promovim dhe Mbështetje të turizmit, dhe prandaj, kapacitetet që ofrojnë shërbime turistike në rajonet rurale mund të gjenden në lidhjet më poshtë:

<http://rural.mk/%D1%80%D1%83%D1%80%D0%B0%D0%BB%D0%B5%D0%BD-%D1%82%D1%83%D1%80%D0%B8%D0%B7%D0%B0%D0%BC/> dhe https://macedonia-timeless.com/eng/plan_yourtrip/getting_around/accomodationrural/



Programi për zhvillim rural sipas rrjedhës dhe masës së fermerit

1"Koalicioni Rural" në fund të muajit korrik 2018, zëvendës ministrit për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi të Ujit ka dorëzuar "Programin për Zhvillim Rural sipas Rrjedhës dhe Masës së Fermerit" Programi ishte hartuar me anë të një procesi paraprak konsultues që ka zgjatur më tepër se një vit dhe ishte realizuar në gjitha 8 rajonet e planifikimit, që në këtë, në mënyrë të drejtë ose jo, ishin përfshirë më tepër se 1000 fermerë të gjitha pjesëve të Maqedonisë. Drejtpërdrejtë ishin përfshirë 800 fermerë në hulumtimin në teren dhe kanë pasur mundësi të shprehin qëndrimet e tyre dhe të vlerësojnë gjendjen me shoqërimin e bujqësisë në nivelin lokal. Hapat vijuese në kuadër të projektit ishin grupe fokusi dhe përgatitje të manualit për bujqësi, 8 trajnime për lo-bim dhe përfaqësim për fermerët dhe ishin realizuar në





secilin rajon të planifikimit, si dhe ndërmarrje të iniciativave lokale qytetare. Në këtë mënyrë ishte inkurajuar aktivizmi qytetar, por edhe ishte rritur njohuria praktike e fermerëve për pjesëmarrje në procesin e krijimit të politikave dhe vendimmarrjes, si në nivelin lokal ashtu edhe atë kombëtar. Si rezultat ishte iniciativa qytetare "Program për Zhvillim Rural sipas Rrjedhës dhe Masës së Fermerit"

që ishte mbështetur nga 40 fermerë. Projekti "Përforcimi i Kapaciteteve të Shoqatave për Pjesëmarrje Aktive në Procesin e Miratimit të Dokumenteve Publike dhe Politikave në Bujqësi dhe Zhvillim Rural" në kuadër të së cilës ishte hartuar iniciativa, ishte shpallur për një prej dhjetë projekteve më të suksesshme të financuar nga Programi për Zhvillim të Shoqërisë Qytetare të Civika Mobilitas.

Vjelja e Mollës së Prespës

"Koalicioni Rural" këtë vit ishte pjesë e manifestimit "Vjelja e Mollës së Prespës" në të cilën ka marrë pjesë me tribun personale: "Përfitimet dhe Sfidat e Bujqësisë së Orientuar drejt BE-së". Në ngjarjen, fjalimin e tij e kishte edhe përfaqësuesi i Delegacionit të BE-së në Maqedoni, z. Samuel Zhbogar, që ka folur për bujqësinë dhe përfitimet që i marrin fermerët e vendeve anëtare të BE-së, pastaj Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit, z. Lupço Nikollovski, që theksin e vendosi në sfidat me të cilat përballohen fermerët dhe në çfarë mënyre të tejkalojnë për në rrugën drejt një bujqësie të zhvilluar evropiane, ndërsa profesori Marijan Kiprijanovski ka folur për aspektet konkrete he përfitimet e politikës së përbashkët bujqësore sipas të cilës kërkon që të përshtatet politika kombëtare bujqësore dhe zhvillimi rural. Nikoqiri i tribunës ishte kryetari i Komunës së Resnjës, z. Zhvivko Gosharevski.





Komuniteti lokal dhe komuna bashkërisht krijojnë strategjinë për zhvillim ekonomik lokal

Ka arritur fundin procesi i krijimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal si pjesë e projektit "**Komuniteti lokal dhe komuna bashkërisht krijojnë strategjinë për zhvillim ekonomik lokal**", të zbatuar nga shoqata "Koalicioni Rural", ndërsa financuar nga ALDA. Në kuadër të procesin ishin zhvilluar tre gupe të fokusit në Komunën Staro Nagoriçane me gjithë palët e interesuara në bashkësitë lokale, ndërsa rezultati i fundit ishte strategji e hartuar për zhvillim lokal ekonomik për tre vitet e ardhshme. Strategjia do të miratohet në seancën e parë të Këshillit të Komunës në muajin janar pas së cilës do të vijojë periudhë e njohjes së popullatës lokale me anë të bashkësive lokale në lidhje me strategjinë si dokument për të mundësuar zbatimin e më të lehtë duke përfshirë banorë të komunës.



Përfshirja e perspektivës gjinore në politikat kryesore të bujqësisë dhe zhvillimit rural

"Koalicioni Rural" në bashkëpunim partnere me Këshillin Kombëtar për Barazi Gjinore" dhe "Shoqatën për Zhvillim Lokal dhe Rural" në kuadër të projektit "**Përfshirja e perspektivës gjinore në politikat kryesore të bujqësisë dhe zhvillimit rural**", që është financuar nga Bashkimi Evropian, ka prezantuar analizën për gjendjen me gratë në rajonet rurale duke përfshirë gjendjen e tyre ekonomike, sociale dhe shëndetësore, por edhe qasja në jetën kulturore dhe sociale në mjedisin në të cilin jetojnë. Analiza ka dalë si rezultat i hulumtimit paraprak në teren me 600 të anketuar (500 gra dhe 100 burra), gjatë së cilës rezultatet ishin të pakëndshme dhe tregojnë që ka shumë për të punuar në fushën e barazisë gjinore që të mund gruaja fermere të fitojë statusin që meriton. Për të kontribuar në këtë pjesë, "Koalicioni Rural" filloi me organizimi në seancave edukative/tra-



jimeve për thirrjen e IPARD 2, me qëllim të motivohen dhe të nxitjen gratë të aplikojnë për këtë dhe kjo të jetë një prej mënyrave për të kontribuar drejt fuqizimit të tyre ekonomik.





Forume për përcaktimin e prioriteteve për vitin 2019 në Komunën e Pehçevës

Në periudhën prej tetor deri nëntor 2018, si pjesë e projektit «Bashkë për Zhvillimin e Komunës» që ka zbatuar Shoqata për Bimë Shëruese dhe Fruta Pyjore «Ambrozija», në partneritet me Komunën e Pehçevës, janë zhvilluar tre seanca forumi në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësues të pushtetit lokal, sektorin joqeveritar dhe afarist si dhe bashkësitë lokale.

Në kuadër të forumit të parë, pjesëmarrësit kanë pasur mundësi të njoftohen me projektin dhe me qëllimet në lidhje me rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve, përcaktimin e prioriteteve për zhvillim dhe përmirësim të jetës në Komunën e Pehçevës, si dhe me procesin e buxhetimit dhe strukturës së Buxhetit të Komunës së Pehçevës.

Në kuadër të forumit të dytë, Kryetari i Komunës së Pehçevës, z. Dragan Trenčovski, ka prezantuar një pjesë të projekteve që do të realizohen gjatë vitit 2016, duke theksuar që përveç këtyre projekteve, si prioritet për realizim do të jenë edhe propozimet e qytetarëve të komunës së Pehçevës, të cilët janë me rëndësi të madhe. Pjesëmarrësit në këtë forum ishin prej gjithsej gjashtë grupeve të punës. Ata kanë prezantuar propozim projektet e tyre, ndërsa një pjesë e tyre, gjatë forumit të fundit, ishin zgjedhur në listën më të ngushtë të prioriteteve që do të përfshihen në programin e Komunës së Pehçevës për vitin e ardhëm.

Në forumin e tretë të pranishmit si anëtarë të grupeve tematike kanë pasur mundësi të votojnë për propozim idetë që ishin hartuar nga forumi paraprak. Projekti që fitoi më tepër vota nga qytetarët është «Rindërtimi i Stacionit të Filtrimit me Instalimin e Mbledhësit». Ky projekt është përfshirë në Programin Vjetor dhe Buxhetin e Komunës së Pehçevës për vitin 2019.

Projekti "Bashkë për Zhvillimin e Komunës" është mbështetur në kuadër të skemës për ri-grantim të projektit «Organizata Qytetare në Shërbim të Demokracisë Lokale» i zbatuar nga ana e ALDA-s, Shoqata e Punëtorëve Financiar të Vetëqeverisjeve Lokale dhe Ndërmarrjet Publike dhe Lëvizja Evropiane në R. e Maqedonisë dhe mbështetet financiarisht nga Bashkimi Evropian. Projekti "Bashkë për Zhvillimin e Komunës" është mbështetur në kuadër të skemës për ri-grantim të projektit «Organizata Qytetare në Shërbim të Demokracisë Lokale» i zbatuar nga ana e ALDA-s,



Shoqata e Punëtorëve Financiar të Vetëqeverisjeve Lokale dhe Ndërmarrjet Publike dhe Lëvizja Evropiane në R. e Maqedonisë dhe ndërmarrje publike me mbështetje financiarisht nga Bashkimi Evropian me anë të instrumentit IPA 2.

Qëllimi kryesor i projektit "Bashkë për Zhvillimin e Komunës" është të rritet pjesëmarrja e opinionit në krijimin e politikave publike në nivel lokal në komunën e Pehçevës. Për të arritur këtë qëllim, aktivitetet janë përqendruar në:

- Përforcimi i kapaciteteve të përfaqësuesve të organizatave qytetare dhe komuniteteve lokale të komunës, për mundësitë dhe mekanizmat për pjesëmarrje aktive në krijimin e politikave lokale;
- Krijimi i mekanizmave për partneritete të qëndrueshme dhe mbështetje financiare të organizatave qytetare në komunën e Pehçevës;
- Ngritje të vetëdijes publike për përfitimet nga pjesëmarrja aktive në proceset e krijimit të politikave në nivelin lokal.





“PARAJSA EKZISTON” – 15 vite “Art Point - Gumno”



www.artpoint-gumno.org.mk


“PARAJSA EKZISTON dhe gjendet këtu, në Slloeshticë, Maqedoni” – ka shkruar Stano Bubam profesor i Akademisë së Artit të Bratislavës gjatë qëndrimit të tij rezidencial në ART POINT – GUMNO gjatë vitit 2012.

Këtë vit, “PARAJSA EKZISTON” është një projekt që paraqet një perspektiv të gjithë që është krijuar/ arritur gjatë 15 viteve të fundit në kuadër të rezidencës ndërkombëtare artistike - një prej programeve kryesore të qendrës ndërkombëtare për art dhe zhvillim të qëndrueshëm “Art Point - Gumno”. Jubileu ishte shënuar me organizimin e ekspozitave, rezidencës artistike dhe me publikimin e një katalogu ekskluziv.

Për nder të jubileut, ishin organizuar **dy ekspozita retroaktive** me vendosjen e veprave të inspiruar nga përjetimet e hapësirave rurale të Demir Hisarit të epërm të rreth 20 artistëve të zgjedhur nga bota (vepra të koleksionit të përhershëm të qendrës):

- Ekspozita e parë ishte hapur më 20 korrik në kishën “Uspesenie na Presevta Bogorodica” në f. Velestovë, në kuadër të 30 edicionit jubile të manifestimit “Nata e Poetëve në Velestovë”;
- Vendosja e dytë ishte e hapur në mënyrë solemne më 27 tetor, në foajenë e Pallatit të Kulturës “Ilinden” në Demir Hisar, dhe në kuadër të manifestimit “Demir Hisari, qyteti i Kulturës, 2018”.

Ajo që pasuroi jubileun dhe që ishte financuar kryesisht nga mjete personale të “Art Point - Gumno” është **rezidenca ndërkombëtare artistike** që u zhvillua prej 22 deri më 31 gusht 2018. 9 profesor dhe studentë të shkollës së njohur për fotografi nga Liberec, Republika e Çekisë, kanë qenë mysafir artistik në f. Slloeshticë



dhe kanë shëtitur nëpër fshatrat e Demir Hisarit për të pasqyruar përgjithmonë magjinë e këtyre viseve dhe frymën e popullatës lokale, dhe janë të inspiruar nga vjershat e Petre M. Andreevski “Mund të Jem” – lëvdatë nga Demir Hisari.

Me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës së RM-së, në dhjetor 2018, nga shtypi doli një **katalog unik** në të cilin, përveç artit të përkryer, është shfaqur mënyra që me anë të artit, fshatrat gjallërohen, promovohet tradita, zgjerohen horizontet dhe lindin miqësi të përhershme, ndërtohen ura mes nyjave të pamundshme, dhe kryesisht, krijohen ambasadore kulturore për Maqedoninë.





Publikimi i Monografisë: “FESTIMI I PIREJIT”

Ky publikim rrëfen historinë për jetën pas vdekjes së Petre M. Andreevski. Jo vetëm për jetën e tij të përhershme, por edhe jetës së gjithë rajonit dhe banorëve – inspirimi i tij i pashterur. Gjithë kjo nga ndodhur falë festimit të dedikuar të Pirejit gjatë 11 viteve të fundit.

Në monografinë, janë shfaqur në kolazh 11 manifestimet e “FESTIMIT I PIREJIT” me anë të fotografive nga dokumentimi i “Art Point – Gumno”, ndërsa në mënyrë autentike edhe gjithë fjalimet për Petre M. Andreevski nga akademik të dalluar, shkrimtarë, aktorë, muzikantë dhe veprimtarë tjerë. Fjalimet ishin shtyllat e aktiviteteve programore të gjitha manifestimet e zhvilluara deri më tani.

Projekti: “Rregullimi dhe Shënimi i “Shtëpisë së Përhershme të Petre M. Andreevski”

Falë mbështetjes simbolike me mjetet e buxhetit të Komunës së Demir Hisarit për vitin 2018, të synuar për financim të aktiviteteve programore për Shoqatat e Qytetarëve dhe Fondacioneve në fushat e kompetencës së komunës, në periudhën prej korrik deri më tetor 2018, “Art Point - Gumno” ka përgatitur udhërrëfyes dhe tabelë informative për shënimin e disa pikave të rëndësishme lidhur me personazhin dhe veprën e Petre M. Andreevski dhe heroinat e tij letrar. Udhërrëfyesit dhe tabela informative do të promovohen në mënyrë solemne në pranverë. Qëllimi i këtij aktiviteti është të kontribuohet për mbështetje të markës SLLOESHTICË që bëhet gjithnjë e më tepër destinacion turistik në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe njëherë të motivohet popullata lokale që të promovojë dhe shesë shërbime turistëve.





“A JENI TË ZGJUAR?”

FB: #budniliste

Nga 17 shtatori, ekipi i Art Point – Gumno” nga f. Sllloeshticë ka filluar me zbatimin e projektit: “Natyra Rregullon – aktivitete për komunitetin për mbrojtje të biodiversitetit”

Projektit zbatohet falë mbështetjes së mbështetjes nga fondi për klimë pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Federale të Gjermanisë, dhe në bashkëpunim dhe koordinim të komunës së Demir Hisarit dhe NPK Komunalec, Demir Hisar.

Qëllimi kryesor i projektit është të kontribuojë për zbutjen e ndikimit të ndryshimeve klimatike me anë të:

- Ngritje të vetëdijes publike për lidhjen mes ndryshimeve klimatike dhe gjendjes me mjedisin jetësor, me fokus në llojlojshmërinë biologjike dhe Agjendës 2030 për zhvillim të qëndrueshëm (Konferenca Rajonale për Bartës së Vendimeve nga Rajoni Pellagonik, në temën: “Çfarë ju kemi lënë gjeneratave të ardhshme: NATYRË ose MBETURINA”, 1 nëntor, Demir Hisar; FB faqe aktive; shkëmbim të përvojave; shtypje të materialeve promovuese);
- Shkëmbim të informacioneve për praktika të mira dhe praktike, pilot zbatim të know-how për menaxhimin me mbeturina organike në rajonin e Komunës së Demir Hisarit (kompostim praktik në 15 lokacione pilot në komunën Demir Hisar);
- Mbështetje të komunës në përpjekjet e saj të themelojë sistem të integruar të menaxhimit me mbeturina të forta me fokus të veçantë në plastikë me qëllim të parandalohet lirimi i POP (p.sh.: vendosja e thasëve të mëdhenj për mbledhjen e PET ambalazheve dhe fushatë edukative për banorët e komunës).





Nxitja e turizmit rural dhe ekologjik me anë të Qendrave të Mençura Informativ Turistike FRET-STIC“

Më 26.12.2018, shoqata e qytetarëve CeProSARD ka festuar 10 vjetorin e ekzistimit dhe punës së suksesshme. Në maj të këtij vitit, shoqata filloi me zbatimin e projektit dyvjeçar “Nxitja e Turizmit Rural dhe Ekologjik me anë të Qendrave të Mençura Informativ Turistike / FRET-STIC”, të financuar nga Bashkimi Evropian. Partnerë të këtij projekti janë Komuna e Tetovës dhe Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug të Kosovës.

Projekti ka për qëllim zhvillimin dhe promovimin e turizmit lokal dhe rajonal me anë të qasjeve inovative. Për realizimin e këtij qëllimi, projekti ka krijuar vegla strategjike që do të mundësojnë kuptimin më të mirë të kërkesave të vizitorëve, dhe në kohën e njëjtë, duke ofruar mekanizma për bashkëpunim më të fortë rajonal mes aspekteve të ndryshme të industrisë, institucioneve qeveritare, sektorit afarist dhe organizatave qytetare. Si rezultat pritet rritje të potencialit turistike, të përshtatur sipas nevojave të grupeve të synimit.

Qëllimet specifike: Themelimi i Qendrave të Mençura Turistike Informativ (STIC), me kapacitet për mbledhjen dhe krijimin e njohurive për potencialet e turizmit të rajonit të Sharrit; kuptim i përmirësuar dhe promovim të potencialeve turistike të rajonit ndërkufitar, me përdorimin e e-sistemeve bashkëkohore dhe bashkëpunim të ndërsjellë.



Grupe synuese: Komunat, organizatat qeveritare që kanë përgjegjësi zhvillimin rajonal, turizmin dhe kulturën; organizatat qytetare, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme; klaserë për turizëm; ekonomike dhe qendrave turistike informative.

Aktivitete: Themelimi i Qendrave të Mençura Turistike Informativ (STIC) të rretëzuara me shembuj të proceseve afariste; themelimi i proceseve të standardizuar afariste dhe programe për trajnim, me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve turistike; hartimi digjital i infrastrukturës dhe ngjarje lidhur me turizmin rural në rajonin ndërkufitar të Sharrit: shtigje dhe shënimi



i trashëgimisë kulturore, kapacitetet e akomodimit, restorante, lokalitete tjera të rëndësishme turistike, festivale, ngjarje tradicionale; krijimi i materialeve promovuese ndërkufitare; ngjarje të përbashkëta ndërkufitare për shkëmbimin dhe promovimin e rezultateve nga aktivitetet e projektit.

Rezultate të pritura:

- Themelimi dhe funksionimi i Qendrave të Mençura Informative Turistike të rrjetëzuara; zhvillimi i platformës së përbashkët e bazuar në procese të standardizuara afariste dhe të koncepteve aktuale për sisteme turistike të informimit; dizajni i proceseve afariste për shërbimin efektive dhe efikas të turistëve me anë të STIC, si dhe mbledhja e të dhënave për sjelljen dhe preferencat e tyre; staf i trajnuar nga dy palët të rajonit për punë në STIC; krijimi i matricës digjitale të infrastrukturës turistike dhe ngjarje në Sharr, përfshirë edhe shtigje të shënuara për ecje, sinjalizim, akomodim, restorante dhe lokalitete të ndryshme turistike dhe ngjarje. Matrica digjitale do të përdoret në iTOP për të krijuar produkte turistike për rajonin ndërkufitar.

Në tetor, në hotelin "Skardus" në Popova Shapkë, në kuadër të projektit, është zhvilluar takimi i parë konsultues me aktorët e projektit në të cilin projekti ishte prezantuar me prezantime të tre partnerëve të projektit «CeProSARD» nga Shkupi, RDA-South» nga Prizreni dhe Komuna e Tetovës. Ditën e njëjtë, ishte zhvilluar edhe takimi i parë i Këshillit Drejtues. Gjatë periudhës vijuese në Prizren ishte zhvilluar një takim për zgjedhjen e ofruesit më të mirë për ndërtimin e objektit për STIC në Kosovë, që është pjesë e aktiviteteve të planifikuara të projektit për krijimin e veglave strategjike që do të mundësojnë kuptimin më të mirë të kërkesave të vizitorëve, dhe në kohën e njëjtë duke ofruar si mekanizma për bashkëpunimin e përforcuar rajonal.





Përshpejtues i njohurisë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme



Fondacioni për Zhvillim Lokal dhe Zhvillim të Teknologjive Informatike - Gjevgjeli (FLORIT) në partneritet me Organizatën e Grave - Shtip kanë zbatuar projektin "Përshpejtues i njohurive për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (MEKA) i financuar nga Bashkimi Evropian me anë të Programit Kombëtar për Ndhimë Tranzitimi dhe Mbindërtim Institucional 2013, Instrumenti për Ndhimë Para Aderimi (IPA), EuropeAid/138-495/ID/ACT/MK.

Gjatë gjashtë muajve të fundit ishin zbatuar një pjesë të aktiviteteve të parashikuara me projektin. Në katër rajone të planifikimit ishin realizuar diskutime me grupe të synimit me qëllim të tejkalimit të pengesave kryesore dhe nevojave të ndërmarrjeve mikro dhe të voglave me themelimin e "Përshpejtuesit të njohurisë për NVM ("EKA)". Grupet e synimit kanë diskutuar në drejtim të identifikimit të barrierave kryesore me të cilat përballohen ndërmarrjet mikro dhe të vogla në Rajonin Lindor, Juglindor, të Shkupit dhe Vardarit, si dhe identifikim të shërbimeve potenciale nga ana e Përshpejtuesit të Njohurisë për NVM (MEKA) Diskutimi i grupeve të synimit ka rezultuar me konkluzione dhe barrierat të mundshme që duhet të tejkalohen ndërmarrjet mikro dhe të vogla.

Në nëntor të vitit 2018, ishte zhvilluar punëtorinë Gjevgjeli për të informuar të pranishmit për aktivitetet e zhvilluar gjatë periudhës së kaluar dhe prezantim të analizës nga pyetësi dhe intervistat individuale. Në punëtorinë kanë marrë pjesë përfaqësues të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, profesorë nga fakultetet, shoqatave afariste dhe sektorit joqeveritar.

Ishte përpunuar edhe ueb faqja e projektit "MEKA" <http://meka.mk/>, e cila vazhdimisht përditësohet me aktivitete të realizuara, informacione të reja, dhe lajme që realizohen në kuadër të projektit.






Tregu E-Rural

Grupi Lokal i Aksionit Bellasica – Orgazhden, në bashkëpunim me shoqatën CEOR Ilovica, kanë krijuar një internet platformë dhe aplikacion celular me titullin Tregu E-Rural, si vegël elektronike për zhvillimin e biznesit në rajon rural, që shërben për promovim dhe shitje të produkteve bujqësore dhe artizane, mekanizim bujqësor, punime dore, kapacitete akomodimi n viset rurale, etj.

Të dhënat relevant për zhvillim të formës dhe mundësitë që ofron kjo platformë interneti dhe aplikacion celular, ishin siguruar nga analiza e parë e zbatuar në territorin e GLA Bellasica-Orgazhden. Me anë të kësaj analize ishin fituar të dhëna për numrin e ekonomike bujqësore, shoqatave të peshkatarëve, kooperativave dhe aktorëve aktiv në këtë sektor, bletarë, artizanë, hotelier, oferta turistike, vende arkeologjike, manifestime kulturore dhe mbrojtjes së pasurive kombëtare. Gjithashtu, janë fituar informacione për problemet me të cilat përballohen grupe e synimit gjatë plasmanit të produkteve të tyre.



Nga kjo, qëllimi i këtij projekte ishte zgjedhja e problemit me plasman të produkteve bujqësore, frutave të detit dhe bimë, mjaltë dhe produkte të mjaltit, produkte artizane, si dhe prezantim dhe promovim të potencialit turistik, pasurinë kulturore dhe autoktone të territoreve të komunave të Bosilovës, Vasilevës, Novo Sellë dhe Strumicë.

Aktivitetet e projektit ishin në drejtim që të mundësojnë: avancim të standardit të jetës së njerëzve, nxitje të aktiviteteve ekonomike, hapje të vendeve të reja të punës, mjedis jetësor i sigurt dhe i ruajtur, prodhimtari të qëndrueshme dhe rentabile bujqësore dhe zhvillim të turizmit rural.

Ky projekt është në lidhje të drejtpërdrejtë me Strategjinë për Zhvillim Lokal të GLA Bellasica-Orgazhden, që ka tre qëllime strategjike:

1. Rritje të konkurrencës në bujqësor, të bazuar mbi krijimin e vlerave me partneritet strategjike dhe bashkëpunim afarist;
2. Zhvillim i ekonomisë së qëndrueshme të llojllojshme rurale të rajonit - subjekte të qëndrueshme ekonomike dhe eko-sociale;
3. Avancim i cilësisë së jetës së popullatës në territorin e GLA-së.

Projekti ishte mbështetur me anë të programit të grantit për ngritjen e kapaciteteve dhe përfaqësimin të shoqërisë qytetare në kuadër të projektit rajonal ALTER – Territore Lokale Aktive për Zhvillim Ekonomik të Rajoneve Rurale, i financuar nga Komisioni Evropian.





Në çfarë mënyre të shfrytëzojmë më mirë IPARD Fondet

Shoqata e Prodhuesve Bujqësor “Agroprodukt” nga Shtipi, si bartës të iniciativës së projektit për shfrytëzim më të mirë të IPARD Fondeve nga ana e fermerëve, e mbështetur nga projekti rajonal ALTER – Territoret Aktive Lokale për Zhvillim Ekonomik të Rajoneve Rurale, gjatë 6 muajve të fundit në mënyrë aktive ka punuar mbi informimin dhe edukimin e fermerëve për IPARD Fondet. Në këtë drejtim, «Agroprodukt» ka zhvilluar shumë takime informative dhe edukative, këshillime të synuar për fermerët, nga fshatrat e kodrave dhe maleve të komunave: Shtip, Karbinci, Radovish dhe Konçë, si përdorues potencial të mjeteve nga IPARD.

Përveç kësaj, në kërkesë të kompanive të rajonit, më 20 nëntor, ishte organizuar një takim informativ në temën “IPARD 2 – Të holla evropiane për bizneset bujqësore», në bashkëpunim me Odën Rajonale me seli në Shtip dhe Agjencisë për Nxitjen dhe Zhvillimin e Bujqësisë në Shtip dhe Karbinci.

Si rezultat i bashkëpunimit mes «Agroprodukt» dhe shoqatës së qytetarëve «Koalicioni Rural», ishin organizuar dy ngjarje: “Vlerat Tradicionale të Rajonit – Mundësitë për Etno Turizëm” (korrik 2018) dhe “Fermerë dhe Ligjet Bujqësore për Shfrytëzimin më të Mirë të Subvencioneve” (tetor 2018).





Aktivite të ZUR “ARTI KRAFT” Shkup

Në periudhën prej korrik deri dhjetor 2018 anëtarët e shoqatës së artizanëve artistë “ARTI KRAFT” – Shkup kanë marrë pjesë aktive në shumë tribuna, seminare, trajnime, punëtori dhe tryeza të rrumbullakët. Këto ngjarje, përveç mundësisë për përfitimin e njohurive të reja, organizata i përdor edhe për promovim personal dhe prezantim të aktiviteteve që i zbatojnë.

Anëtarët e shoqatës gjithashtu kanë marrë pjesë në shumë manifestime të vendit si dhe në shtetet fqinje ku kanë prezantuar aktivitetet e shoqërisë dhe kanë ekspozuar punimet e punuara.

Gjatë muajit korrik përfaqësues të shoqatës kanë marrë pjesë në LOKUM FEST në Manastir dhe etno festivalin në Pehçevë me rastin e festës fetare Pavlovdën.

Gjatë muajit gusht, ZUR “ARTI KRAFT” ka prezantuar punimet e dorës në disa manifestime vendore dhe të huaja. Fillimisht, në Graçanicë të Kosovës, pastaj në Berovë në manifestimin «Pjesa e Malishevës në Pëllëmbë» dhe prej 24-29 ka zhvilluar një vizitë studimore në R. e Kroacisë bashkë me Shoqatën e Grave në Biznes të R. së Maqedonisë. Gjatë kësaj vizite studimore ishin vizituar qytetet: Vukovar, Zagreb, Otoçac, Sinj, Split dhe Dubrovnik. Gjatë kësaj vizite studimore shoqata ka themeluar bashkëpunim me shoqatën “Gaçanka” nga Otoçac.

Gjatë muajit shtator, shoqata ka marrë pjesë në ditët e trashëgimisë kulturore në Gjilan – Kosovë dhe Prishtinë. Për vitin e tretë me rend, shoqata “ARTI KRAFT”, me rastin e 8 shtatorit ka organizuar manifestimin “Të Ruajmë Pasurinë tonë Kombëtare”. Manifestimi u zhvillua prej 5 deri 7 shtator në NU Muzeu i Maqedonisë në Shkup.



Gjatë muajve vijues shoqata ka marrë pjesëmarrje aktive në disa manifestime siç janë: Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Gruas Rurale më 15 tetor dhe manifestimi treditore ekonomik, kulturor, turistik dhe etno i dedikuar ditës së 13 nëntorit, në të cilën kanë marrë pjesë shumë artistë, afaristë, artizanë nga Kosova, Serbia, Shqipëria dhe Mali i Zi.

Në mënyrë tradicionale, edhe këtë vit “ARTI KRAFT” ka organizuar tregun e vitit të ri, këtë herë në periudhën prej 10 dhjetor deri më 7 janar në sheshin e Shkupit.





Festimi i Ditës Ndërkombëtare i Gruas Rurale

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas rurale, që festohet më 15 tetor, Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë dhe Federata Kombëtare e Fermerëve, në partneritet me Fakultetin e Shkencave Bujqësore dhe Ushqim, ka organizuar një ngjarje të përkushtuar rreth rolit të gruas në rajonet rurale dhe pabarazitë dhe sfidat me të cilat ata përballen. Ngjarja ishte mbështetur nga Qendra Suedeze për Bashkëpunim We Effect dhe UN Women - Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave - Zyra në Shkup. Ngjarja e organizuar në Etno Selo, Kuçkovë, afër Shkupit, ka mbledhur rreth 150 gra fermere, gra nga rajonet rurale, OJQ dhe përfaqësues të qeverisë qendrore dhe lokale, që kanë diskutuar për sfidat dhe hapat vijues për përmirësimin e statusit social dhe ekonomik të grave në rajonet rurale.





Të flasim për ndryshimet klimatike

Projekti “Të Flasim për Ndryshimet Klimatike” synon të mobilizojë qytetarët, komunitetet në vend me anë të edukimit të tyre për atë se çfarë rëndësie kanë ndryshimet klimatike, pasojat, si dhe mënyrën që individualisht çfarë ndikimi kemi mbi ndryshimet klimatike, çfarë mund secili prej nesh të bëjë për të zbutur pasojat dhe në çfarë mënyre të transmetojmë këto informacione në komunitetet tona me qëllim të shkakimit të ndryshimit.

Organizatave qytetare janë zëri ynë para liderëve politik dhe për këtë arsye ky projekt synon të përforcojë dhe të bashkojë organizatat qytetare nga vendi në drejtim të rritjes së pjesëmarrjes në krijimin e politikave ambicioze për zbutjen e ndryshimeve klimatike. Si pjesë e projektit “Të Flasim për Ndryshimet Klimatike” gjatë 3 muajve të fundit ishin zbatuar 8 trajnime të synuar për organizatat qytetare në vend që janë aktive në sektorët e mjedisit jetësor, zhvillimit rural dhe pylltarisë. Qëllimi i trajnimeve ishte ngritja e kapaciteteve të organizatave qytetare për punë më të suksesshme dhe më efektive të organizatave, si dhe ngritje të kapaciteteve të OJQ-ve për kuptimin e ndryshimeve klimatike dhe komunikim të kësaj problematike me opinionin më të gjerë.

Qëllimi përfundimtar i projektit “Të Flasim për Ndryshimet Klimatike” është të krijohet koalicion kombëtar për klimë që do të ketë anëtarë të fuqishëm dhe mirë të informuar prej organizatave qytetare të afet për të transmetuar mesazhet prej komuniteteve të tyre deri tek liderët politik. Për këtë qëllim, më 26 dhjetor 2018, ishte zhvilluar tryeza e parë e rumbullakët prej gjithsej tetë, në të cilin ishin zhvilluar diskutime më të hollësishme teknike në lidhje me rolin e organizatave qytetare në punën e temës së ndryshimeve klimatike në sektorë të ndryshëm. Ishin shqyrtuar gjithë sektorët që janë me rëndësi për kontributet kombëtare ndaj ndryshimeve klimatike (NDC). Organizatat qytetare të pranishme kanë arritur një konkluzion njëzëri që duhet themelimi i një koalicioni për klimën në kuadër të territorit që do të punonte në ngritjen e vetëdijes për ndryshimet klimatike në gjitha sektorët relevant.

Si një vend në zhvillim që nuk ka mjete të mjaftueshme financiare për të përballuar me pasojat e ndryshimeve klimatike, ne konsiderojmë që është e nevojshme një dëgjim i ndërsjellë dhe bashkëpunim aktiv mes qytetarëve, sektorit qytetar, sektorit privat, institucio-



net dhe liderët politik në drejtim të një aksioni ambicioz për zbutjen e ndryshimeve klimatike në vendin tonë. Pikërisht për këtë koalicioni për klimë do të punojë në çështjet vijuese:

- Të ngritët vetëdija publike dhe kuptimi për këtë temë, ashtu që qytetarët do të veprojnë për zgjedhje të problemeve.
- Të iniciohen diskutime në nivelin lokal dhe kombëtar në lidhje me çështjet kryesore prioritare klimatike, ashtu që aktivitet klimatike do të jenë mirë të drejtura dhe të rëndësishme.
- Përfaqësim për integrim të ndryshimeve klimatike si temë ndër sektoriale në gjitha planet dhe programet sektoriale, ashtu që do të merren parasysh aspektet klimatike dhe do të përfshihen në mënyrë të sinkronizuar dhe akorduar.

Projekti “Të Flasim për Ndryshimet Klimatike” është financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Eko-Svest, CNVP dhe DEM. Të gjitha aktivitetet aktuale mund të ndiqni dhe të informoheni për ndryshimet klimatike me #TëFlasimpërKlimën në rrjetet sociale ose të shkruani në elena@ekosvest.com.mk.





Përfshirje e rritur e anëtarëve të RZR në arritjen e Qëllimeve Strategjike të Rrjetit

Asambleja Vjetore e Rrjetit për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë ishte organizuar prej 21 deri më 22 shtator në Strumicë. Kjo mundësi e mbledhjes së 31 përfaqësuesve nga 27 organizata – anëtare të RZE të RM-së, ishte përdorur për të arritur pjesëmarrje më të madhe të anëtarësisë në zhvillimin e strategjisë së RZR për periudhën 2019-2022. Konsultimi ka stimuluar një diskutim të frytshëm mes anëtarëve të RZR lidhur me çështjet kryesore dhe mundësitë e rrjetit. Si rezultat i punës dyditore, ishin përcaktuar prioritetet strategjike dhe një propozim version të strategjisë dhe planit të veprimit ishte zhvilluar.



Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë më tutje ka zhvilluar punën tematike që ka dalë nga tre qëllimet kryesore strategjike:

- Përfaqësimi me vendimmarrësit, të cilët mbrojnë dhe promovojnë të drejtat dhe interesat e popullatës rurale, dhe kontribuojnë për zhvillimin e barabartë dhe të qëndrueshëm të rajoneve rurale;
- Rrjetëzimi dhe themelimi i bashkëpunimit me organizatat e jashtme dhe aktorët (përfshirë edhe mediet) për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira, si dhe promovimi i të drejtave dhe interesave të përfituesve;
- Ngritja e kapaciteteve personale dhe kapacitetet e anëtarëve, si dhe përforsimi i procedurave të punës, për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin e punës.

Puna tematike e RZR-së është zbatimi i qasjes nga fundilart në praktikë, ku Rrjeti krijon qasjes drejt zhvillimit rural me anë të përfshirjes aktive të anëtarëve dhe aktorëve tjerë relevant në rajonet rural për të arritur qëllimet strategjike. Puna tematike përbëhet nga krijimi grupeve të punës me aktorë kryesorë në zhvillimin rural, duke organizuar seminare dhe punëtori, përgatitja e publikimeve tematike dhe materialeve tjera informative.





Puna tematike synon plotësimin e qëllimeve vijuese:

- Identifikimi i prioriteteve kryesore dhe sfidave që mund të zbatohen me anë të strategjisë dhe planit të verimit të RZR;
- Shkëmbimi i përvojave që çojnë në sukses, siç janë masat e dobishme, veglat dhe qasjet.

RZR ka përcaktuar punën në katër tema kryesore, secila duke u përqendruar në nën-tema, të përcaktuara paraprakisht nga anëtarët dhe udhëheqja e RZR-së.

Takimi i parë i grupit tematik “Përfshirja Sociale”, nën-grupit “Rinia Rurale” ishte zhvilluar më 15 dhjetor në pralinë e 22 përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile - anëtarë të RZR-së. Gjatë takimit, shumë të dhëna të ndryshme nga kërkime të ndryshme ishin prezantuar, lidhur me përfshirjen e të rinjve në punën e organizatave të shoqërisë civile dhe miratimi i politikave në nivel lokal.

Më 25 dhjetor, një nën-grup tjetër në kuadër të grupit të njëjtë tematik, që është “Barazia Gjinore” ishte nisur. Takimi i parë i këtij grupi tematik ishte vizituar nga 22 përfaqësues të 14 OJQ-ve - anëtarë të RZR-së.

Ishin zgjedhur koordinatoret dhe raportuesit për dy grupet tematike. Gjatë vitit vijues, do të themelohen grupet tjera tematike të RZR-së.

Këto aktivitete do të kontribuojnë për ngritjen e kapaciteteve të Rrjetit për Zhvillim Rural që financiarisht mbështeten nga We Effect.





Të rinjtë nga rajonet rurale për integrim të Maqedonisë në BE

Në gjysmën e dytë të vitit 2018, projekti *Të Rinjtë e Rajoneve Rurale për Integrim të Maqedonisë në BE*, në mënyrë intensive ka punuar në motivimin dhe përforsimin e vetëdijes tek të rinjtë për nevojën dhe fuqinë e kontributit të tyre aktiv për integrim të suksesshëm evropian të Republikës së Maqedonisë. Në këtë drejtim ishin organizuar 5 punëtori për edukim të bashkëmohatarëve në Shtip, Pehçevë, Dellçevë, Strumicë dhe Koçan, në të cilën kanë marrë pjesë gjithsej 136 të rinj të rajonit. Në këto ngjarje, përfaqësuesit e organizatave rinore të rajonit lindor dhe juglindor të planifikimit që kanë kaluar trajnimin për vlerat e BE-së dhe procesin e integritit të Maqedonisë kanë shkëmbyer njohuritë e përfutur me bashkëmohatarët e tyre. Përveç transferimit të njohurive të përfutura, trajnuesit e rinj kanë praktikuar shkathtësitë e përfutura për prezantim, edukim të drejtpërdrejtë dhe diskutim paneli me të rinjtë e rajonit të tyre.

Gjatë muajit të tetorit 2018, projekti ka zhvilluar 5 punëtori në shkollat e mesme të Rajonit Lindor dhe Juglindor edhe atë në Shtip, Radovish, Strumicë, Berovë dhe Gjevgjeli. Grupet e synimit ishin nxënësit e vitit të katërt dhe të rinj tjerë të interesuar që ishin të informuar me anë të organizatave partnere lokale. Punëtoritë kanë përfshirë moderator të Këshillit Rinor të Maqedonisë i cili me anë të veglave përkatëse ka edukuar të rinjtë për përfshirje sociale, politika rinore, politika rinore, programe aktuale vendore dhe të BE të synuar për të rinjtë në Maqedoni, mundësitë për punësim dhe informacione tjera të dobishme për aktivizëm rinor. Pjesëmarrësit kanë pasur mundësi që për gjitha institucionet relevante siç janë qeveria, komuna, shkolla, prindërit dhe aktorë tjerë të përpilojnë mesazhe të shkurta me sugjerime për përmirësim të ndonjë aspekti të jetës së tyre dhe përditshmërisë.

Më 11 dhe 12 dhjetor 2018 në Shtip dhe Strumicë ishin zhvilluar forume për këshillim karriere për të rinjtë. Në punëtoritë kanë marrë pjesë më tepër se 130 të rinj nga rajoni lindor dhe juglindor i planifikimit, si anëtarë të organizatave joqeveritare ashtu dhe nxënës të shkollave të mesme, institucioneve lokale publike përfaqësues të sektorit afarist dhe tjera. Disa ekspertë të Rrjetit për Zhvillim Rural të Kroacisë dhe kryetari



i Rrjetit për Zhvillim Rural të Serbisë kanë prezantuar shembuj të punësimit, rrjetëzimit dhe informimit të popullatës rurale me anë të projekteve për turizëm rural dhe prodhimtari të ushqimit ku bashkohen mundësitë e njerëzve nga fshatrat fqinje për rritjen e ofertës dhe konkurrencës. Gjithashtu ishin prezantuar përparësitë për aplikantë deri në moshën 40 vjeçe për masat në programin kombëtar për zhvillim rural dhe IPARD programit. Në pjesën e dytë përfaqësues të Këshillit Kombëtar të të Rinjve në Maqedoni (KKRM) kanë prezantuar programin shtetëror për garanci rinore, si dhe shembuj praktik të zbatimit në rajonin e pilotimit në Strumicë.





BE-ja mbështet promovimin e Ekonomisë së Gjelbër në vendet e Ballkanit

Projekti rajonal «Rrjetëzimi dhe Përfaqësimi për Ekonomi të Gjelbër» i financuar nga Be-ja, ishte nisur në prill të vitit 2018. Ky projekt trevjeçar përdor një qasje pjesëmarrëse të aktorëve të ndryshëm për të promovuar dhe lehtësuar prezantimin e konceptit të ekonomisë së gjelbër, si dhe të mbështet aderimin drejt CAP të BE-së, veçanërisht në fushën e mbrojtjes mjedisore dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Zbatuesi kryesor i projektit është Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë, ndërsa partnerë të projektit janë: Rrjeti për Zhvillim Rural i Kroacisë, Rrjeti për Zhvillim Rural i Shqipërisë, Rrjeti për Zhvillim Rural i Malit të Zi, Rrjeti për Zhvillim Rural i Serbisë, Rrjeti i Organizatave për Zhvillim Rural i Kosovës dhe Rrjeti për Zhvillim Rural i Bosnjës dhe Hercegovinës.

“Ekonomia e gjelbër synon zvogëlimin e rreziqeve mjedisore dhe dallimeve ekologjike, dhe synon zhvillimin e qëndrueshëm pa mos dëmtuar mjedisin. Për këtë, ne do të punojnë në zhvillimin e kapacitetit dhe do të sigurojnë nën-grante për OJQ specifike për të pilotuar projekte të gjelbër sipërmarrëse, me anë të cilës ata do të demonstronjë që qëndrueshmëria është e mundshme duke u kujdesur edhe për mjedisin dhe duke qenë të përgjegjshëm në mënyrë sociale». tha Petar Gjorgievski, Drejtori i projektit «Rrjetëzimi dhe Përfaqësimi për Ekonomi të Gjelbër”.

Duke synuar përforcimin e OJQ-ve specifike në punën e përgjithshme, gjatë periudhës prej shtatorit deri në nëntor 2018, projekti ka organizuar tre trajnime të trajnerëve në nivelin rajonal, duke mbuluar temat vijuese: Qeverisja transparente dhe e përgjegjshme; planifikimi dhe raportimi dhe menaxhimi financiar; dhe llojllojshmëria e financimit. Me këtë aktivitet, partnerët e projektit “Rrjetëzimi dhe Përfaqësimi për Ekonomi të Gjelbër - NAGE”, do të sigurohet që anëtarët e RRBZHR të kenë njohuri dhe shkathtësi të fuqishme gjenerike për menaxhim, që mund të transferohet në nivele bazë, por edhe të kopjohet në gjitha aktivitetet dhe veprimet e ardhshme që dot të zbatohen nga RRBZHR.



Pas këtij trajnime, trajnerët kanë filluar me transferimin e njohurisë të mbledhur në organizatat tjera në nivelin kombëtar, për të zhvilluar kapacitetet e tyre dhe për të siguruar që kapacitetet e menaxhimit nuk janë pengesë që do të eliminojë iniciativat e qytetarëve dhe do të pengojë zbatimin e projekteve të suksesshme të sipërmarrjes së gjelbër si pjesë e programit të nëngrantimit. Në gjashtë prej vendeve të zbatimit, seria e parë e trajnimeve ishte organizuar gjatë periudhës nëntor dhe dhjetor 2018. Ky proces i transferimit të njohurisë do të vazhdojë gjatë vitit të ardhshëm duke organizuar trajnime në secilën prej vendeve, duke mbuluar dy temat tjera: planifikimi dhe raportimi dhe menaxhimi financiar; dhe llojllojshmëria e financimit.





Zhvillimi i kapaciteteve të Rrjetit Ballkanik Rural për t'u bërë aktor i përgjegjshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të rajoneve rurale në Rajonin e Ballkanit Perëndimor

Me mbështetjen e We Effect, Rrjeti Ballkanik Rural punon në mënyrë aktive për zhvillimin e kapaciteteve për t'u bërë aktor i përgjegjshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të rajoneve rurale në Rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjatë periudhës prej shtator deri tetor, Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë, si koordinator i aktiviteteve të mbështetur nga We Effect, ka zhvilluar një draft version të RRBZHR statutit, që ishte diskutuar gjatë një takimi të organizuar në Shkup, në dhjetor, më 13 dhe 14. Përfaqësues të rrjeteve zhvillimore rurale të Serbisë, Republikës së Maqedonisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Shqipërisë, Kosovës dhe Malit të Zi janë mbledhur gjatë kësaj punëtorie për të përcaktuar një draft të fundit të RRBZHR Statutit, që do të shërbejë si bazë në procesin e mëtutjeshëm të formalizimit të RRBZHR-së.

Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë ka prezantuar aktivitetet e planifikuara për vitin e ardhshëm si pjesë e mbështetjes së WE Effect për zhvillimin e RRBZHR-së si dhe ka prezantuar një koncept për themelimin e një Grupi për Barazi Gjinore si një trup këshillimor në sajë të BRFN si dhe organet tjera qeverisëse dhe ekzekutive. Grupi për Barazi Gjinore ishte themeluar në shtator, kur 6 prej anëtarëve të emëruar të grupit, ishin mbledhur në Shkup dhe kanë diskutuar për funksionimin e ardhshëm të këtij grupi në kuadër të RRBZHR. Ata kanë identifikuar prioritetin kryesor vijues që duhet të përfshihet në strategjinë e RRBZHR-së: In-korporomi i gjinisë në kuadër të RRBZHR-së si prioritet



tërthor strategjik që do të zbatohet për secilën prej prioriteteve strategjike të RRBZHR-së.

Konsulenti i angazhuar për zhvillimin e trajnimeve për vlerësimin e nevojave të rrjeteve anëtare të RRBZHR-së ka bërë publike zbulimet nga hulumtimi. Sipas nevojave të identifikuar me anë të ANT, aktivitetet do të planifikohen për ngritjen e kapaciteteve të organizatave anëtare të RRBZHR-së.

Gjatë punëtorisë dy ditore të frytshme ishte nisur një diskutim mes anëtarëve të RRBZHR-së lidhur me strukturën organizative dhe provizionet e anëtarësimit. Pritet që gjatë vitit 2019, RRBZHR-ja të ketë përcaktuar Statutin dhe procedurat për funksionim të organeve drejtuese dhe ekzekutive.





Mbledhja PREPARE

Mbledhja PREPARE është ngjarja kryesore vjetore e Rrjetit PREPARE, të organizuar çdoherë në shtet tjetër. Këtë vit, Mbledhja PREPARE ishte organizuar prej 30 tetor deri më 1 nëntor në Pejë, Kosovë. Përfaqësuesit e organizatave anëtare të Rrjetit PREPARE dhe anëtarët e Rrjetit Ballkanik për Zhvillim Rural – RRBZHR, që janë partnerë në projektin rajonal ALTER, kanë marrë pjesë në ngjarjen. Ata janë mbledhur për të shkëmbyer dhe për të mësuar nga njëri-tjetri me një objektivë të përbashkët: Të kontribuojnë për rrjetëzimin e zhvillimit të qëndrueshëm rural.

Mbledhja filloi me punëtorinë në rrugë për pjesëmarrësit që të njoftohen me punën dhe aktivitetin e disa fermerëve dhe individëve të angazhuar në aktivitete bujqësore dhe blegtorale në disa prej lokaliteteve rurale në Kosovë. Seanca e fillimit të Mbledhjes ishte vizituar edhe nga Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillim Rural i Kosovës, përfaqësues të zyrës së Bashkimit Evropian, si dhe pjesëmarrës tjetër të institucioneve qeveritare dhe organizata të shoqërisë civile. Ministri, në seancën e panelit, ka prezantuar situatën

e përgjithshme të sektorit rural në Kosovë, duke theksuar arritjet, vështirësitë, sfidat dhe nevojat që përballohet komuniteti rural në Kosovë, dhe duke nënvizuar përdorimin e Programit për Zhvillim Rural, si një mundësi e mirë për mbështetjen e aktiviteteve të gjithë atyre që investojnë në zhvillimin e rajoneve rurale. Gjatë punëtorisë, pjesëmarrësit në grupet e punës kanë diskutuar tema lidhur me: Qasjen LEADER, ngritjen e kapaciteteve dhe qëndrueshmëria e Rrjetit PREPARE, roli i OJQ-ve në zhvillimin e politikave rurale. Rezultatet kryesore të diskutimit ishin prezantuar nga secili grup në fund të seancës.

Një prej konkluzioneve më të rëndësishme të Mbledhjes ishte përkushtimi i përbashkët i gjithë pjesëmarrjeve që të këmbëngulin për përforsim të bashkëpunimit mes aktorëve të shoqërisë civile, përfshirë edhe rrjetet dhe organizatat e rajonit / Evropës duke përfaqësuar tek institucionet publike për të mirësuar mbështetjen për zhvillimin rural, që do të ketë efekt mbi përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitetin rural.





Forumi për Zhvillimin e Politikave Rurale të vendeve të Evropës Juglindore 2018

Forumi për Zhvillimin e Politikave Rurale të vendeve të Evropës Juglindore 2018 me fokus në "Llojlojshmërinë e aktiviteteve ekonomike në rajonet rurale dhe roli i OJQ-ve në mbështetjen e llojlojshmërisë" ishte zhvilluar në Jahorinë, Bosnjë dhe Hercegovinë më 16, 17 dhe 18 tetor 2018. FZHPR 2018 ishte organizuar nga Rrjeti Ballkanik për Zhvillim Rural dhe Fondacioni për Zhvillim i Turqisë në kuadër të projektit ALTER - Territore Lokale Aktive për Zhvillim Ekonomik të Rajoneve Rurale. Pjesëmarrësit e FZHPR gjithashtu kishin mundësinë të marrin pjesë në Forumin e Politikave Bujqësore (FPB) 2018 "Politikat Bujqësore: Përcaktues i Zhvillimit Rural Rajonal dhe Perspektivat e BE-së për EJL" që ishte organizuar nga Grupi i Përhershëm Rajonal për Zhvillim Rural (GPR) në EJL.



Forumi për Zhvillimin e Politikave Rurale të vendeve të Evropës Juglindore 2018 ka shërbyer si platformë për dialog mbi perspektivat e llojlojshmërisë së aktiviteteve ekonomike në rajonet rurale të vendeve të EJL dhe ka siguruar mundësi për dialog mes gjithë aktorëve relevant. Pas shkëmbimit të përvojave mbi llojlojshmërinë e aktiviteteve ekonomike në rajonet rurale të vendeve të Ballkanit Perëndimor, Turqisë dhe Be-së, pjesëmarrësit ishin ndarë në tre grupe pune sipas temave vijuese:

- Llojlojshmëria e aktiviteteve ekonomike në rajonet rurale – si të themelohet një mjedis stimulues;
- Roli i organizatave qytetare në mbështetjen e llojlojshmërisë së aktiviteteve ekonomike në rajonet rurale;
- Sipërmarrja sociale si mundësi për llojlojshmëri të aktiviteteve ekonomike në rajonet rurale dhe mbështetja e punësimit të grupeve të marginalizuara.

Në kuadër të secilës prej këtyre grupeve, ishin identifikuar çështjet kryesore dhe problemet, duke dhënë rekomandime përkatëse politike lidhur me llojlojshmërinë e aktiviteteve ekonomike në rajonet rurale të rajonit. Në fund, pjesëmarrësit e FZHPR 2018 kishin mundësi që të marrin pjesë në seancë plenare të Forumit për Politika Bujqësore (FPB) 2018, me mundësi për të kontribuar në rekomandimet e politikave.

